



Ftesë me shkrim për prindërit që kanë fëmijët në kopsht

Të nderuar prindër

Fëmija juaj frekuenton një kopsht për fëmijë i cili merr pjesë në programin „Kualiteti në shkollat multikulturale“ (QUIMS). Me programin QUIMS kantoni i Cyrihut i përkrah shkollat me një pjesë të madhe të fëmijëve me gjuhë të huaj. Në vitet 2014 deri 2017 këta kopshte për fëmijë do të punojnë për atë që ta bëjnë bashkëpunimi me prindërit mundësisht më të mirë.

Si e gjykoni ju personalisht bashkëpunimin me kopshtin e fëmijës tuaj? Çfarë ecën mirë? Çfarë ka ndoshta ende për tu përmirësuar? – Kopshti i fëmijës tuaj dhe drejtoria arsimore janë të interesuar për vlerësimin tuaj. Mendimi juaj e ndihmon shkollën tuaj për ta përmirësuar bashkëpunimin me prindërit.

Për këtë arsye ne ju lutemi që ta plotësoni njërin pyetësor deri më datën 15.12.2016. Me rëndësi është që të marrin pjesë mundësisht të gjithë prindërit. Vetëm kështu pyetësori mund të japë rezultate të vlefshme. Ju lutemi që ta plotësoni vetëm një pyetësor të vetëm për familjen tuaj (babai dhe nëna mund ta bëjnë këtë së bashku).

Të gjitha përgjigjet në pyetësor do të trajtohen në mënyrë anonime dhe në konfidencë të rreptë. Për askënd në shkollë nuk do jetë e mundur të gjendet se cilat përgjigje personale ju i keni dhënë.

Këtë anketim ju mund ta gjeni në internet nën:

<https://www.spectrum3.ch/umfrage/eltern>

Në pyetësor pyetet për emrin e shkollës në të cilën shkon fëmija juaj. Jepni si emër atë të shkollës „**[Namen der Schule]**“.

Ju pyetësorin mund ta plotësoni edhe në një gjuhë tjetër. Ai është përkthyer në shqip, anglisht, frëngjisht, italisht, portugalisht, serbisht/kroatisht/bosnisht/, spanjisht, dhe turqisht.

Në qoftë se ju në shtëpi nuk keni lidhje interneti, atëherë nuk duhet ti përgjigjeni këtij pyetësori. Por ju mundet ti pyesni ndoshta fqinjët ose mësuesin e fëmijës tuaj, se a mundeni eventualisht ta përdorni kompjuterin e tyre.

Për pyetje shtesë në lidhje me QUIMS-in, ju lutemi drejtohuni: markus.truniger@vsa.zh.ch

Për pyetje shtesë në lidhje me pyetësorin, ju lutemi drejtohuni: mroos@sunrise.ch

Ju falënderojmë përzemësisht që tani për pjesëmarrjen tuaj në këtë anketim!

Me nderime

Markus Truniger, udhëheqës kantonal i programit QUIMS

Markus Roos, i ngarkuari i jashtëm për mbledhjen e statistikave